

ON SOME TERMS OF GENERAL LINGUISTIC IN RELATION TO ALBANIAN LINGUISTICS

MBI DISA TERMA TË GJUHËSISË SË PËRGJITHSHME NË RAPORT ME TË GJUHËSISË SHQIPTARE

Flamur SHALA¹

¹Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", Kosovë
²flamur.shala@uni-prizren.com

Abstract

This paper deals with some terms that name linguistic phenomena and their interpretations, not included in the texts that deal with linguistic phenomena for Albanian, without being limited within the punctuation marks of the sentence. The theoretical treatment of linguistic, grammatical, sociolinguistic, generativist phenomena and especially of the grammar of the Albanian language text, as a relatively new field of Albanian linguistics, requires as much knowledge of the study methodology as a set of scientific methods, as much as of the terminology that marks and specifies the phenomena according to the fields of linguistics.

Phonetics, lexicology and traditional grammar of the Albanian language do not include the treatment of some linguistic phenomena, according to new theories of linguistic system studies. Consequently they do not even include the terms for them. For the treatment of linguistic, grammatical phenomena in particular, it is necessary to go outside the traditional framework; the new treatments of general linguistics should be taken as a basis for the reinterpretation of certain linguistic phenomena of Albanian and the interpretation of terms that are not used in traditional linguistics for Albanian.

The treatment of linguistic phenomena is not limited within punctuation marks, it goes beyond them. The linguistics of the text has opened new horizons. The treatment and reinterpretation of linguistic phenomena with contemporary terminology does not diminish the achievements of Albanian linguistics so far.

Keywords: *linguistic term, terminology, linguistic phenomenon, reinterpretation, etc.*

Abstrakti

Në këtë punim trajtohen disa terma që emërtojnë dukuri gjuhësore dhe interpretimet për to, të papërfshira në tekstet që trajtojnë dukuri gjuhësore për shqipen, pa u kufizuar brenda shenjave të pikësimit të fjalisë. Trajtimi teorik për dukuritë gjuhësore, gramatikore, sociolinguistike, gjenerativiste e në veçanti të gramatikës së tekstit të gjuhës shqipe, si fushë relativisht e re e gjuhësisë shqiptare, kërkon, sa dije për metodologjinë studimore si tërësi e metodave shkencore, po aq edhe për terminologjinë që shenjon dhe saktëson dukuritë sipas fushave të gjuhësisë.

Fonetika, leksikologjia dhe gramatika tradicionale e gjuhës shqipe nuk përfshijnë trajtimin e disa fenomeneve gjuhësore, sipas teorive të reja të studimeve të sistemit gjuhësor. Rrjedhimisht nuk i përfshijnë as termat për to. Për trajtimin e fenomeneve gjuhësore, gramatikore në veçanti, duhet të dilet jashtë kornizës tradicionale; duhet marrë për bazë trajtimet e reja të gjuhësisë së përgjithshme për rinterpretimin e dukurive të caktuara gjuhësore të shqipes dhe interpretimin e termave që tejkalojnë gjuhësinë tradicionale për shqipen.

Trajtimi i dukurive gjuhësore nuk kufizohet brenda shenjave të pikësimit, del përtej tyre. Gjuhësia e tekstit ka hapur horizonte të reja. Trajtimi dhe rinterpretimi i dukurive gjuhësore me terminologji bashkëkohore nuk zbehin të arriturat e deritanishme të gjuhësisë shqiptare.

Fjalët kyçe: *termi gjuhësor, terminologji, dukuri gjuhësore, rinterpretim etj.*

1. Hyrje

Çdo studim i veçantë për gjuhën dhe jo vetëm, përfshin një tërësi termash të veçantë dhe të përshtatshëm. Studimet bashkëkohore mbi dukuritë gjuhësore interpretohen përmes termave të caktuar si emërtues të dukurive, interpretimeve dhe përkufizimeve për to. Dihet, termi është emërtim i përcaktuar dhe i përpiktë, që shpreh një nocion të caktuar të një fushe. (FGJSSH, 1980:1987). Mendimin dhe interperimin mbi dukuritë gjuhësore në gjuhësinë e përgjithshme (gjuhësia e përgjithshme rendit mendimin dhe studimet për gjuhën dhe interpertimet mbi dukuritë gjuhësore, sipas autorëve, periudhave, rrymave të cakturara) i karakterizon emërtimi me terma të caktuar të dukurive gjuhësore, të cilët bëhen “sinonim” i interpretimit dhe i të kuptuarit të atyre dukurive gjuhësore.

Në gjuhësinë shqiptare, në fonetikë e në gramatikën tradicionale dhe në tekste të tjera universitare, që kanë të bëjnë me përshkrimin e dukurive gjuhësore fonetike, morfologjike, sintaksore e leksikologjike, përdoret kryesisht terminologjia tradicionale përmes së cilës interpretohen dhe përkufizohen dukuri gjuhësore sipas fushave përkatëse. Në këtë kuadër, janë të pamohueshme të arriturat e gjuhësisë shqiptare, e cila ndjek trendet bashkëkohore të mendimit teorik mbi dukuritë gjuhësore, të cilat shenjohen edhe përmes një terminologjie që emërton këto dukuri sipas interpretimeve po ashtu të reja e të pastuduara deri vonë.

Studiues të gjuhës shqipe, kanë nisur kaheerë të hapin horizonte të reja, qoftë me përkthime të librave të autorëve eminentë të gjuhësisë së përgjithshme, qoftë me studime të drejtpërdrejta të gjuhës shqipe lidhur me dukuritë gjuhësore, sipas fushave të studimit, siç është gjuhësia e tekstit, një fushë e re në gjuhësinë shqiptare, bazuar në të arriturat e deritanishme të gjuhësisë mbi dukuri të caktuara gjuhësore.

Një nga çështjet me rëndësi, të gjuhëtarëve me të arritura shkencore, është trajtimi dhe përkufizimi i dukurive gjuhësore, sipas fushave, të shenjura me terma gjuhësorë, me përdorimin e termave për emërtimin e dukurive gjuhësore dhe përkufizimin e tyre, duke saktësuar interpretimet a rinterpretimet për to. Fonetika, gramatika e gjuhës së sotme shqipe dhe leksikologjia, përfshijnë një tërësi termash që shenjojnë dukuritë gjuhësore sipas fushave, përshkrimin dhe interpretimet mbi dukuritë gjuhësore që përkufizohen dhe emërtohen me terma të caktuar në përdorim, sot e kësaj dite.

Plotësimi me interpretime shtesë a të reja të dukurive gjuhësore, qartëson më tej kuptimin e termit të caktuar. Përdorimi i termave, që shenjojnë dukuri gjuhësore “të reja” të patrajtuara, të papërkufizuara, të papërdorur në tekstet universitare të fonetikës - fonologjisë, morfologjisë, sintaksës e leksikologjisë shqipe duhet të zgjerohet duke u bazuar në publikimet më të reja që përmbajnë terma gjuhësorë (Leksikon i termave të fonetikës dhe fonologjisë, Rugova, 2019; Leksikon i termave të gramatikës, në botim).

Një shpërfaqje e parë e një përdorimi sistematik të termave që emërtojnë dukuri gjuhësore të përgjithshme nis me përkthimin në gjuhën shqipe të librave si: “Kursi i gjuhësisë së përgjithshme” (Sosyr, 1977), “Elemente të gjuhësisë së përgjithshme” (Martine, 1983), “Fjalori enciklopedik i shkencave të ligjërimit” (Dykro-Todorov, 1984), të përkthyer nga R. Ismajli si dhe “Gjuha-hyrje në sudimin e ligjërimit” (Sapir, 1980), i përkthyer nga V. Nuhiu si dhe “Parime të fonologjisë” (Trubeckoi, 1985) i përkthyer nga M. Bejta etj. Në parathënien e tij, përkthyer në frengjisht nga Zhan Kantino, lidhur me librin “Parime të fonologjisë”, Martine thotë se “Këto rrethana e paraqesin librin e Trubeckoit si kurorëzim të një periudhe vendimtare në historinë e gjuhësisë, dhe i japin kështu një vlerë të përhershme, për t’u bërë i parapëlqyer, i domosdoshëm për t’u kuptuar më mirë natyra e faktit gjuhësor” (Trubeckoi, 1985:10).

Sikurse edhe librat e tjerë edhe ky libër përmban terma që emërtojnë dukuri gjuhësore të trajtuara dhe të përkufizuara sipas pikëpamjeve autoriale, që dominojnë mendimin gjuhësor edhe sot.

2. Trupi i punimit

2.1. Rishikimi i literaturës

Fonetika e fonologjia, gramatika e gjuhës standarde shqipe dhe leksikologjia sikurse edhe fusha të tjera të gjuhësisë si dialektologjia, stilistika dhe degët e reja, si sociolinguistika, psikolinguistika e gjuhësia gjenerative deri te gjuhësia e tekstit, përmbajnë terma, përgjithësisht, për të emërtuar dukuri gjuhësore sipas fushave. Në tekstet e fonetikës e fonologjisë të gjuhës shqipe, morfologjisë, sintaksës e leksikologjisë, shenjohen dukuri gjuhësore sipas një terminologjie standarde, përgjithësisht tradicionale. Ka terma, si *kryefonemë*, *deiks-i*, *temë e remë*, *kolokim-i*, që nuk përdoren dhe si dukuri gjuhësore nuk trajtohen e rrjedhimisht edhe nuk interpretohen në tekstet tradicionale universitare të shqipes së sotme.

Termin *arkifonemë*, që përherë të parë e përmend Trubeckoi (1984:360-71.) dhe kryefonemë (archiphonèmes, Martine, 1980:76; 1983:116.) nuk përdoret në fonetikën-fonologjinë e gjuhës shqipe (Dodi, 2003, Hamiti, 2012). Ky term (varianti themelor) në gjuhësinë e përgjithshme del me dy interpretime kryesore, (Rugova, 2019:195) për të cilat do të flasim në pjesën e diskutimit. Elementeve deiktike se ato shënojnë afërsinë dhe largësinë gjatë përdorimit të përemrave dëftorë (*ai - ky, ajo - kjo, këta- ata* etj.), sipas gramatikës tradicionale u mjafton ky përkufizim (Gramatika 1, 2002:230), ndërsa *deiktikët-deiksi* në gjuhësinë e përgjithshme ka kuptim më të gjerë (Rugova & Sejdiu Rugova, 2015:163-165) se sa kuptimi që interpretohet në gramatikën shqipe.

Termet *temë* dhe *remë*, më shumë si terma të gjuhësisë së përgjithshme (Lyons, 2001:311), shenjojnë dukuritë gjuhësore që nuk i trajton sintaksa e gjuhës shqipe. Po ashtu termi *sintagmë* në sintaksën e shqipes krahasuar me trajtimin që i bëhet në gjuhësinë e përgjithshme (Marine, 1983:156), nuk bart kuptimin që ka dhe shpesh krahasohet me *përbërës (sintaksorë)* a me *togfjalëshin*. Termi *ligjërim* në gjuhësinë shqiptare përdoret me më shumë kuptime, edhe me kuptimin të *folur* (Memushaj, 2005: 35). Interpretimet që sjellin për këta terma e të tjerë si *modaliteti, hironimet e kolokimet* (Rugova & Sejdiu Rugova, 2015:39-40) *monema, kundërshtia*, si terma që emërtojnë dukuri gjuhësore paradigmatiche dhe sintagmatike (Martine, 1983:145, 59) do të flasim në pjesën e diskutimit të këtij punimi.

2.2. Pyetjet që shtrohen

Termet tradicionale që përdoren për të emërtuar dukuritë gjuhësore në fusha të caktuara të gjuhësisë si fonetika dhe fonologjia, morfologjia, sintaksa e leksikologjia, nuk kapërcejnë ende krejt kufirin e termave tradicionale mbi dukuritë gjuhësore, bazuar në të arriturat e mendimit bashkëkohor për fenomene gjuhësore sipas fushave. Ka terma mbi dukuritë që mund të shtjellohen mëtej dhe të riinterpretohen, bazuar në interpretimet e dukurive gjuhësore të emërtuara me terma të gjuhësisë së përgjithshme. A duhet të bëhet rishikimi dhe përdorimi i disa emërtimeve, bazuar në përparimin e mendimit bashkëkohor për gjuhën?

2.3. Metoda

Në këtë punim zbatohet metoda e krahasimit. Përdorimi i termave në gjuhësinë e përgjithshme lidhet me trajtimin dhe interpretimin e dukurive gjuhësore të fonetikës, gramatikës e leksikologjisë si dhe të fushave të tjera, po aq sa konsiderohet se edhe termat që përdoren në tekstet sipas fushave gjuhësore të shqipes së sotme, trajtojnë, interpretojnë dhe përkufizojnë dukuri të caktuara gjuhësore. Dukuri të caktuara sipas fushave, në gjuhësinë e përgjithshme, trajtohen, interpretohen dhe emërtohen me terma që gjuhësia shqiptare në tekstet universitare për shqipen nuk ka arritur t'i përdorë, ngase ka munguar trajtimi dhe interpretimi i tyre, kuptimin e të cilave e mbulon një term që përdoret tashmë në trajtesat e gjuhësisë së përgjithshme. Fjala është për termat në tekstet e lëndëve që përshkruajnë dukuritë fonetike, gramatikore dhe të leksikologjisë, si disiplina që përshkruajnë sistemin e gjuhës së sotme shqipe. Krahasimi bëhet në mes termave dhe interpretimit të dukurive gjuhësore që emërtohen me ta, të përdorur-papërdorur, dhe termave që emërtojnë dukuri gjuhësore me interpretime të përafërta a ndryshe.

Janë marrë për shqyrtim të dhënat mbi termat që përmbajnë tekstet universitare të shqipes së sotme, terma që përdoren në gjuhësinë përshkruese, në veçanti në fonetikë, morfologji, sintaksë, leksikologji, në njërën anë dhe të dhënat mbi termat që përdoren në gjuhësinë e përgjithshme. Këta terma emërtojnë dukuri gjuhësore, qoftë për të saktësuar ndërlidhjen mes termit dhe dukurisë së interpretuar a rinterpretuar, qoftë për të pasuruar me interpretime dukuritë gjuhësore të trajtuara jo sa duhet, brenda përshkrimit të strukturës së shqipes së sotme, sipas fushave që përbëjnë sistemin e saj gjuhësor.

2.4. Diskutim

Fjala term është një emërtim i përpiktë i një nocioni, i përcaktuar mirë, në një fushë të shkencës, të teknikës, të artit, të jetës shoqërore etj. Emërtimi përmes një termi shprehet me një fjalë ose me një togfjalësh; që shpreh një nocion të caktuar dhe që përdoret kryesisht nga profesionistët e një fushe të caktuar; term shkencor (teknik, ushtarak, shkencor etj) (FGJSSH, 1980:1987). Trajtimi dhe rinterpretimi i dukurive gjuhësore me terminologji bashkëkohore, në kuadrin gjithëtekstor, nuk zbehin të arriturat e deritanishme të gjuhësisë shqiptare.

Gjuhësia e përgjithshme merret me mendimin për gjuhën që nga koha e vjetër, greke, romake, indiane etj. deri në ditët e sotme. Këtu bëhet fjalë më shumë për mendimin dhe teoritë bashkëkohore mbi gjuhën, të sajuara me metodologji bashkëkohore lidhur me konceptet, nga ato themelore, si gjuha, shkrimi, gjuha e ligjërimi, kodi, shenja e mesazhi, sintagmatika e paradigmatica etj. Trajtimi teorik për dukuritë gjuhësore, fonetiko-fonologjike e gramatikore, sociolinguistike, psikolinguistike, gjenerativiste e në veçanti të gramatikës së tekstit të gjuhës shqipe, si fushë relativisht e re e gjuhësisë shqiptare, kërkon sa dije për metodologjinë studimore si tërësi të metodave shkencore po aq edhe për terminologjinë që emërton e shenjon dhe saktëson kuptimin mbi dukuritë gjuhësore sipas fushave të gjuhësisë.

Në "Leksikonin e termave të fonetikës dhe fonologjisë së shqipes" (Rugova, 2019) përfshihen rreth 600 terma, kryesisht të fonetikës dhe fonologjisë dhe në "Leksikoni i termave të gramatikës së shqipes" libër në botim nga ASHAK, janë diku rreth 1300 terma të gjuhësisë, që emërtojnë dukuri gjuhësore të ndryshme, kryesisht gramatikore. Janë përfshirë edhe termat e gjuhësisë së përgjithshme që përdoren në gjuhësinë shqiptare.

Nga këta terma, përveç atyre që bëjnë një prerje me termat në gjuhësinë e përgjithshme dhe përdoren për të shënuar të njëjtat interpretime dhe përkufizime të dukurive të caktuara gjuhësore në tekstet universitare sipas fushave të gjuhësisë shqiptare, si në fonetikë, morfologji e sintaksë, ka sish që nuk i ka fonetika a gramatika shqipe, ose i ka si emërtim, por që duhet të ketë interpretime shtesë a ndryshe nga to. Ka terma që emërtojnë dukuri gjuhësore të shqipes të patrajtuara hollësisht deri më tani. Pa një trajtim në tekstet për shqipen as termi nuk përdoret. Mund të themi pak më shumë, se termat dalin nga një “pajtueshmëri” a “marrëveshje”: p.sh. Ligji i Omit, merr emrin sipas zbuluesit të tij dhe Om-i është njësia për matjen e rezistences elektrike. Natyra e dukurive gjuhësore lejon më pak emërtime të tilla, por nuk mund të themi krejt se nuk dalin nga një “pajtueshmëri”.

Shpesh i referohemi Sosyrit (1977) për termin *parole - të folur*, të njëjtësuar pa arsye me termin *ligjërim*. Ai (Sosyr) e ndan gjuhën duke i dhënë përparësi të *folurit*, duke qenë të folurit është akt e gjuha "magazinë" (Memushaj, 2014:35.). Në psikolinguistikë fjalët përbëjnë leksikun mendor që në aktin e prodhimit gjuhësor përzgjidhen e leksikalizohen, (Paçarizi, 2012), ndërsa, kështu, ligjërimi shërben si bartës i mendimit (Martine, 1983:39). E pa të folur nuk ka gjuhë e pa gjuhë nuk ka të folur, prandaj të folurit dhe gjuha nënkuptojnë njëri-tjetrin dhe duhet të konsiderohen si dy faqe të një dukurie, që e mbulojnë njëra-tjetrën: *ligjërimin* (Trubeckoi, 1985:37). E në anën tjetër gjejmë të thuhet *ligjërimi i folur* dhe *ligjërimi i shkruar*.

Kështu, ligjërimi është më shumë se të folur e se të shkruar, është bashkë: *gjuhë e folur*, *gjuhë e shkruar*, *gjuhë e të menduar*. Nuk ka të menduar pa leksik mendor, pa gjuhë. Po ashtu *ligjërimi* si term del “ekuivalent” me diskursin. *Diskursi* është e thëna dhe e pathëna bashkë - teksti dhe konteksti - procesi i aktivizimit të tekstit duke e lidhur me një kontekst (Rugova, 2009:41). Nga ky këndvështrim, *ligjërimi* nënkupton bashkë *kompetencën* dhe *performancën*, *gjuhën* dhe *të folurit*. Performanca e Çomskit është thjesht përdorim i gjuhës në situata konkrete të një përvoje aktuale të të folurit a të shkruarit, e cila për bazë ka *kompetencën*, që mund të përkufizohet si aftësi "gjenetike", zotërim i përdorimit të gjuhës së folësve idealë, emërtim që nuk është ekuivalent me “gjuhën” e Sosyrit. Koncepti i fjalës *ligjërim* përfshin kuptimin e termave të sipërshënuar, është më abstrakt. “Ligjërimi është shumë formash” dhe “i shtrirë në shumë rrafshë” (Sosyr, 1977:45).

Termi *kryefonemë* nuk përdoret në fonetikën shqipe, sepse, dukuria fonetike që e shkakton kryefonemën, neutralizimi, sikur ka mjaftuar ta shenjojë procesin kur dy tinguj me tipar dallues (zëshmerinë), kur takohen në të njëjtin vend brenda një fjale, *neutralizohen* dhe formojnë një fonemë, afërsisht me gjysmëtipar të të dyjave (*th e dh, k e g*, tipar në toskërishte), as si e para as si e dyta, por si bashkësi e tipareve relevante të dy fonemave, që Martine e quan *kryefonemë* (Martine, 1982:117) dhe se kryefonema realizohet atje ku ka neutralizim. Termi *kryefonemë* (arkifonemë, variant themelor) në *Leksikun e termave të fonetikës dhe fonologjisë* (Rugova, 2019:117, 195) është variant themelor, “variant i paramenduar i fonemës, i nyjëtuar pa asnjë kontekst tingullor”. Në fjalët *agim*, *ari*, *dritare*, *a-të* janë variante të së njëjtës fonemë, ndërsa *A* pa rrethim fonetik është variant themelor, *kryefonemë* (Rugova, 2019:195).

Termi *kontrastiv* përdoret në *gjuhësi kontrastive*, kur kemi të bëjmë me krahasimin e gjuhëve, ndërsa *gjuhësi krahasimtare*, kur kemi të bëjmë me krahasimin e gjuhëve në zhvillimin e tyre historik. Gjuhët që fliten sot, duke qenë afër njëra tjetrës kontrastojnë (Lindita Sejdiu-Rugova, 2019:16, 17). Studimi mbi to gjen prerjen midis tyre, të përbashkëtat (strukturën, tipologjinë, leksikun etj.) Ndërkaq, termin *kontrast* (kundërshti) në "Elemente të gjuhësisë së përgjithshme" të Martinesë, e gjejmë të përkthyer nga Rexhep Ismajli (1983:59,60) me termin shqip *kundërshti*.

Të njëjtin nuk e gjejmë në tekstet për shqipen e përshkruar, as kontrast, ndërsa e gjejmë interpretimin e mirëfilltë të dukurisë së njëjtë gjuhësore me termin a konceptin *sintagmatik*. Njësitë gjuhësore pranë njëra-tjetrës, në rrjedhën e ligjëritimit janë në raporte *kundërshite*, sintagmatike. Për *monemën* Martine (1983:45-46), kur flet për njësitë gjuhësore, thotë se një thënie, ose një pjesë e saj që ka kuptim quhet shenjë gjuhësore, e cila përmban një të shenjuar (kuptimi a vlera e saj) dhe një shenjues që e manifeston shenjën në formë tingullore. Sipas Martinesë, shenja nuk analizohet në rrjedhë shenjash, prandaj ai përdor termin *monemë*. E monema nuk është ekuivalent savant i saj. “Dallimi themelor nuk qëndron midis monemave të leksikut dhe monemave të gramatikës, po midis monemave indikatorë të relacioneve të tjera” (Martine, 1983:46). Nga ky këndvështrim monema nuk është morfemë, sepse kjo e dyta ka vetëm formën dhe nuk analizohet në rrjedhë. Nuk ka sintagmë pa dy monema së paku.

Janë *monema autonome* ato, kur “vendi i tyre në thënie nuk varet nga pjesa tjetër e thënies”. Nuk është e njëjtë të thuhet: *duhet të ecësh shpejt* dhe *shpejt duhet të ecësh* (Martine, 1983:155) dhe janë *monema funksionale*-monemat që shërbejnë për ta shenjuar funksionin e një moneme tjetër: *Djali u aksidentua me veturë; me* është monemë funksionale.

Deiksi nuk është vetëm ai elementi deiktik *k* e *a* (*këtu, aty, ky, ai*) është edhe *dje, sot e pardje*. Rugova & Sejdiu Rugova (2015:163) shpjegojnë se “akti i të folurit varet shumë nga informacioni që kemi për kontekstin: *ku, kur* është thënë fjalia dhe *kush* e ka thënë” (Svorou, 1993:1-41), për të vazhduar se këto janë “tri dimensione të rëndësishme, si të ashtuquajtura *qendër deiktike* e të gjitha ngjarjeve gjuhësore”. Sipas termave të studuesve bashkëkohorë si Huddleston, Stirling (2002:1451, sipas Rugova & Sejdiu Rugova, 2015:164), “ku interpretimi deiktik i referohet një objekti në një situatë të të kumtuarit dhe interpretimi anaforik i referohet një atesedenti (paraprijësi)”, Fillmore (1997) e Lyons (1995), argumentojnë shprehje të tjera deiktike që lidhen me gjuhën në përdorim (deiksi i diskutit – shprehje që u referohet formave brenda tekstit) dhe me kontekstin shoqëror (deiksi shoqëror – si tregues që përfshin përfaqësimin e marrëdhëneve shoqërore) të aktit të të folurit (Rugova & Sejdiu Rugova, 2015: 164.).

Modaliteti dhe *mënyra* nuk e nënkuptojnë njëra-tjetrën. Sipas studimeve dhe interpretimeve të reja, modaliteti është me kuptim përtej modalitetit mënyror, ose modaliteti është kategori kuptimore, kurse mënyra është kategori gramatikore. Modaliteti i gramatikalizuar është vetë mënyra (Rugova & Sejdiu Rugova, 2015:176.). Me të njëjtën folje modale (mund) varësisht nga *folja kryesore* (zakonisht në lidhore) shprehet modaliteti i ndryshëm (deontik – *Ai mund të shkojë në universitet.*) dhe modaliteti që shpreh një folje tjetër kryesore (dinamik - *Ai mund të kërcej në ujë*).

Për *sintagmën*, Martine (1983:156-57) thotë se ajo shënon çdo kombinim monemash në raporte më të ngushta “sesa që janë raportet që kanë elemente të tjera të thënies”, bashkë me “monemën funksionale që e lidh këtë kombinim me pjesën tjetër të thënies”. Sipas tij sintagma është një fjalë si *djali, djalë* dhe *-i*. Pse, sepse përbëhet prej dy monemave. Edhe *i* vjen nga përemri (a)i djalë. Kemi të bëjmë me nyjën shquese të prapavendosur. Mehmet Çeliku, (2012:6), thotë se, termi që ai e përdor tashmë, *përbërësi i fjalisë*, është barasvlerës me sintagmën, frazën a grupin e fjalëve. Termi “përbërës” në gjuhësinë strukturaliste “konstituent” “construction”, ka përdorim shumë të gjerë, për fonemën, morfemën, ndajshitesën, rrënjën e fjalës, përfshirë sintagmën e sifjalinë. (M. Çeliku, 2012:6).

Në gramatikën tradicionale, *konstituentët bërthamë* të fjalisë dëftore janë kryefjala dhe kallëzuesi. Fjalia mund të plotësohet nga adjunktët si p.sh. *Studenti i mirë shkon përditë në mëngjes në universitet*. Konstituentët bërthamë janë Studenti (kryefjala) dhe shkon (kallëzuesi). Adjunktët janë përbërësit fakultativë: i mirë, përditë, në mëngjes etj. Kur hiqen nuk e prishin fjalinë nga pikëpamja gramatikore (Lyons, 2001:311).

Tash fjala është për *temën* dhe *remën*. Përbërësit bërthamë janë të lidhur me emrin dhe foljen që nga Greqia e vjetër, sepse fjalia duhet të ketë diçka për të cilën flitet dhe diçka për të cilën duhet të thuhet për të. Në këtë kuptim Hockett (Lyons, 2001:311) subjektin (njeriu) a objektin (sendi) i quan *temë*, kurse thënieën për ta e quan *remë*. Jo gjithëherë kryefjala është *temë* p.sh.: *Këtë lajm/nuk e kam dëgjuar më parë*. Hockett kryefjalën dhe kallëzuesin i dallon si koncepte nga *tema* dhe *rema*, megjithëse ato shpesh përputhen. Sipas Hockett *tema* (Këtë lajm) i prin *remës* (nuk e kam dëgjuar më parë). Tema tregon se mbi çka flet folësi, ndërsa rema jep diçka të re (Lyons, 2001:312). Por, varësisht nga konteksti, mund të ketë fjali ku tema është vetë folja, varësisht nga kërkesa që shtohet brenda kontekstit.

Hironimet, (Rugova & Sejdiu Rugova, 2015:150) janë raporte semantike, në të cilat shënohet një pjesë përbërëse për tërësinë (*Festivali i Kanës shënon suksesin e radhës. Kana do të pasohet edhe me festivalet e tjera*. “Në figura stilistike realizohet me sinekdokë” (pjesa për tërësinë oxhaku-shtëpia) ose “me metoniminë (kur një koncept emërtohet sipas një fjale tjetër që ka lidhje me përmbajtjen e saj)” (Rugova & Sejdiu Rugova, 2015:150). Kana është *metonimi* për Festivalin e Kanës. Është concept i paradigmaticës.

Kolokimet “lidhen me kuptimin që del nga konkurrenca e parashikueshme” (Rugova & Sejdiu Rugova, 2015:151.). Dalin mes fjalëve në relacione të specifikuar (Jackson, Zë Amvella 2004:113). Këtë dukuri gjuhësore, gjuhësia shqiptare nuk e ka trajtuar e as përkufizuar deri s’voni nga Rugova&Sejdiu Rugova, (2015:151.). Deri te ky koncept na dërgon lidhja leksikore sintagmatike. E shohim te sinonimet, çiftet që qëndrojnë mes vete në një marrëdhënie të dukshme leksiko – semantike: kongresi dhe politikani, shkolla dhe nxënësi. Te sinonimet marrëdhënia nuk është e mundshme pa një referim të caktuar me një njësi tjetër. Te *kolokimet* marrëdhënia është jo e drejtpërdrejtë, më e vështirë për t’u definuar. p.sh. *Kryeministri i ka njohtuar deputetët për të arriturat dhe planet për të ardhmen. Debati në parlament ka qenë i nxehtë*. Marrëdhënia *deputet-parlament* është *kolokim*.

3. Përfundime

Ky punim nxjerr në pah disa terma të gjuhësisë së përgjithshme që emërtojnë dukuri gjuhësore të patrajuara sa duhet në tekstet universitare të shqipes së sotme, si në fonetikë-fonologji, morfologji, sintaksë e leksikologji. Ka terma në tekstet universitare që nuk e mbulojnë krejt kuptimin e dukurisë gjuhësore që emërtojnë, sepse ata kapin vetëm një pjesë të dukurisë, krahasuar me kuptimet që mbulon i njëjti term, të cilat i ka vënë në pah tashmë gjuhësia e përgjithshme, saktësisht gjuhësia e tekstit (deiksi, modaliteti, sintagma etj).

Në disa fusha, dukuritë gjuhësore që trajton gjuhësia e përgjithshme, bazuar në mendimin bashkëkohor e shkencor mbi dukuritë gjuhësore, kanë mbetur ende të patrajuara. Janë pjesë e trajtimit tradicional të strukturës së shqipes. Disa terma të gjuhësisë së përgjithshme emërtojnë dukuri gjuhësore të patrajuara dhe rrjedhimisht të papërshtatshme sa duhet në tekstet universitare, në fusha të caktuara studimore për shqipen e sotme. Një tekst i mirë i përmbledhur i një fushe të re që trajton dukuri gjuhësore bazuar në gjuhësinë e tekstit është “Gramatika e tekstit të gjuhës shqipe” (2015).

Conclusions

This paper highlights some terms of general linguistics that name linguistic phenomena not treated enough in the university texts of today's Albanian, such as in phonetics-phonology, morphology, syntax and lexicology. There are terms in university texts that do not cover the entire meaning of the linguistic phenomenon they name, because they capture only a part of the phenomenon, compared to the meanings covered by the same term, which have already been highlighted by general linguistics, precisely the linguistics of text (deixy, modality, syntagma, etc.).

In some areas, the linguistic phenomena that general linguistics deals with, based on contemporary and scientific thought on linguistic phenomena, have still remained untreated. They are part of the traditional treatment of the structure of Albanian linguistics. Some terms of general linguistics name linguistic phenomena that are not treated and therefore not described enough in university texts, in certain fields of study for today's Albanian. A good summary text of a new field that deals with linguistic phenomena based on text linguistics is "Text Grammar of the Albanian Language" (2015).

Literatura

- [1]. Çeliku, M., 2012. *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*, Tiranë.
- [2]. Dë Sosyr, F., 1977. *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë.
- [3]. Dodi, A., 2004. *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- [4]. Dykro-Todorov, 1984, *Fjalor i shkencave të ligjërimit*, Prishtinë.
- [5]. Gr. autorësh, 1980. *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Tiranë.
- [6]. Gr. autorësh., 2002. *Gramatika e gjuhës shqipe-1*, Tiranë.
- [7]. Gr. autorësh., 2002. *Gramatika e gjuhës shqipe-2*, Tiranë.
- [8]. Hamiti, A., 2011. *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup.
- [9]. Ismajli, R., 1974, *Shenjë e ide*, Prishtinë.
- [10]. Lyons, J., 2001. *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Tiranë.
- [11]. Martine, A., 1983. *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë.
- [12]. Memushaj, R., 2014. *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë.
- [13]. Rugova, B., 2009. *Gjuha e gazetave*, Prishtinë
- [14]. Rugova, B., 2019. *Leksikon i termave të fonetikës dhe fonologjisë*, Prishtinë.
- [15]. Rugova, B. - Sejdiu-Rugova, L., 2015. *Hyrje në gramatiën e tekstit të gjuhës shqipe*, Prishtinë.
- [16]. Sapir, E., 1980. *Gjuha-hyrje në studimin e ligjërimit*, Prishtinë.
- [17]. Sejdiu Rugova, L., 2019. *Klauzat e varura të përcaktuara sipas përmbajtjes në gjuhën angleze dhe korrespondencat e tyre sintaksore në gjuhën shqipe*, Prishtinë.
- [18]. Rugova, B., 2012, *Terminologjia e gjuhësisë së tekstit në gjuhën shqipe*, Prishtinë
- [19]. Thomai, J., 2020. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- [20]. Trubeckoi, N.S., 1985. *Parime të fonologjisë*, Prishtinë.
- [21]. FGJSSH, 1980. Tiranë.